

Shteti i Nju-Jorkut
Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm

ERIC T. SCHNEIDERMAN
PROKUROR I PËRGJITHSHËM



Departamenti i Arsimit të Shtetit të Nju-Jorkut
Universiteti i Shtetit të Nju-Jorkut

MARYELLEN ELIA
KOMISIONERE PËR ARSIMIN
DREJTOR I UNIVERSITETIT TË SHETIT TË NJU-JORKUT

27 shkurt 2017


Masat e fundit në lidhje me emigrimin nga zyrtarët federalë kanë ngjallur frikë dhe konfuzion në të gjithë vendin. Rezidentët e shtetit të Nju-Jorkut, të cilëve janë zotuar t'u shërbejnë agjencitë tona si dhe Këshilli i Regjentëve i Shtetit të Nju-Jorkut, kanë komunikuar drejtpërdrejt me agjencitë tona rreth shqetësimeve dhe pyetjeve që kanë ngritur këto masa. Zyrat e Prokurorit të Përgjithshëm (Office of the Attorney General, "OAG") e Shtetit të Nju-Jorkut dhe Departamenti i Arsimit i Shtetit të Nju-Jorkut (State Education Department, "SED") shkruajnë sot për t'u konfirmuar studentëve, shkollave, familjeve dhe komuniteteve kudo në shtetin e Nju-Jorkut se shkollat tona do të mbeten streha të sigurta ku mund të studiojnë të gjithë studentët.

Sipas ligjit "Për arsimin" të Shtetit të Nju-Jorkut, fëmijët mbi pesë vjeç dhe nën njëzetënjë vjeç që nuk kanë marrë diplomë të shkollës së mesme kanë të drejtë të ndjekin shkollat shtetërore të distriktit në të cilin banojnë, pa paguar tarifë shkollimi. Gjithashtu, distriktet shkollërore duhet të sigurohen që të gjithë studentët brenda moshës së arsimit të detyrueshëm të ndjekin studimet me kohë të plotë.¹ **Fëmijët e paregjistruar, si p.sh. fëmijët të cilët janë qytetarë të SH.B.A-ve, kanë të drejtë të ndjekin shkollat me kohë të plotë nëse përmbushin kërkesat e moshës dhe të rezidencës të përcaktuara me ligj.** Në fakt, disa dekada më parë Gjykata e Lartë e SHBA-së vendosi, në çështjen *Plyler v. Doe*, se distriktet shkollërore nuk mund t'u mohojnë studentëve arsimimin publik falas për shkak të statusit të tyre si person i paregjistruar ose pa nënshtet

shkollore mund t'ju duhet të mbledhin të dhëna të caktuara në pajtueshmëri me ligjeve shtetërore dhe/ose federale, ne kemi këshilluar gjithashtu që ato duhet ta kmië

tjerë federalë të emigrimit paraqiten në shkollë dhe kërkojnë të takojnë studentët (për intervista dhe/ose marrje në pyetje), distrikti shkollor duhet të këshillojë të gjithë stafin që të kontaktojë menjëherë përgjegjësën dhe përfaqësuesin ligjor të distriktit shkollor për udhëzime, veçanërisht në lidhje me detyrimet e tij sipas ligjit "Për arsimin", *Plyler*, si dhe "NYFCA" përpara se të autorizojnë takimin me një student.

Kërkesat për akses në të dhënat e studentëve. Në mënyrë të ngjashme, agjencitë tona këshillojnë që, pas marrjes së një kërkesë nga zyrtarët e emigracionit për akses në të dhënat e shkollimit të studentëve, distriktet shkollore duhet të konsultohen menjëherë me përfaqësuesit e tyre ligjorë, duke qenë se pajtueshmëria me këtë kërkesë nëpërmjet zbulimit të informacionit mund të përbëjë shkelje të "FERPA".⁶ Në përgjithësi, "FERPA" ndalon dhënien e informacioneve identifikuese personale (Personally Identifiable Information, "PII"), të cilat gjenden në regjistrat shkollorë të studentëve, nga distriktet shkollore që marrin fonde federale, pa pëlqimin e prindit apo studentit të zgjedhur. "FERPA" e lejon zbulimin e këtij informacioni pa pëlqim vetëm nëse ai përmbush disa kushte të kufizuara të përcaktuara në rregulloret e zbatimit të ligjit. Këto kushte të kufizuara përfshijnë kërkesat e bëra nga individë të veçantë të qeverisë federale.⁷



MaryEllen Elia
Komisionere për Arsimin



Eric T. Schneiderman
Prokuror i Përgjithshëm